



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.562/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Afijete Sada Gillogjani dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e Isa Xhemajlaj, kandidat për Kryetar Komune të Gillogocit nga radhët e subjektit politik NISMA, me seli në Prishtinë, dega në Gillogoc, për shkak të mospërputhjes së rezultateve, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 02.11.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e Isa Xhemajlaj, kandidat për Kryetar Komune nga radhët e subjektit politik NISMA, me seli në Prishtinë, dega në Gillogoc, për shkak të mospërputhjes së rezultateve, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

### A r s y e t i m

Me datën 01.11.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Isa Xhemajli, nga radhët e subjektit politik NISMA, me të cilën thekson se në Qendrën e votimit në Gradicë në VV 0305E/01R, anëtarët e KVV nuk i kanë shënuar rezultatin real të kutive në formularin e përputhjes së të dhënave dhe rezultateve (FPR) për të gjithë kandidatët për Kryetar të Komunës, në rezultatin e publikuar në WEB faqe të KQZ-së, në VV0305E/1R figurojnë 33 vota, në FPR të njëjtit VV figurojnë 22 vota. Parashtruesi i ankesës pretendon se kjo mospërputhje tregon qartë se është bërë shkelje procedurale ligjore nga anëtarët e KVV-ve. Kërkon nga PZAP-i të hapet kutia në këtë vendvotim dhe të bëhet rinumërimi i saj.

Parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur deklaratat e vëzhguesve të subjektit të tyre politik, kopjen e rezultatit përfundimtar të publikuar në web faqen e KQZ-së dhe Formularin Përfundimtar të Rezultateve (FPR) të plotësuar në VV.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesa është e pa bazuar**

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve ankimore në ankesë nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse për të vërtetuar pretendimet në ankesën e parashtruar, në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, ku është përcaktuar: “*se vendosja për ankesa dhe apele nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”. Paneli gjatë vendosjes për një ankesë i shqyrton dhe i heton me kujdes të gjitha provat e bashkangjitura në ankesë dhe kur vlerëson se pretendimet ankimore nuk janë të provuara me prova nga

parashtruesi i ankesës, siç është në rastin konkret, ngase parashtruesi i ankesës nuk e ka bashkangjitur asnjë provë lidhur me pretendimet e tij.

Paneli vlerëson se pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës se me rastin e shpalljes së rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, për zgjedhjet lokale të datës 22.10.2017 për Kryetar të Komunës së Gllogocit, ka pasur mospërputhje, janë të pabazuara në ligj, siç kërkohen me nenin 117 par3, nenin 118 të LZP-së dhe nenin 5 par.7 pika c) e Rregullës Nr.02/2015 Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
ZL. Anr.562/2017 më datën 02.11.2017.



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.